



Democracy for Development
Demokraci për zhvillim
Demokratija za razvoj

PËRFSHIRJA E QYTETARËVE NË VENDIMMARRJE NË NIVEL LOKAL



PËRFSHIRJA E QYTETARËVE NË VENDIMMARRJE NË NIVEL LOKAL

Prishtinë, mars 2023



Të drejtat e autorit ©2023. **Demokraci për Zhvillim (D4D)**.

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç citimeve të pjesëve të shkurtra me qëllim të kritikës dhe rishikimit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të rikthimit të të dhënave, ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjeti, elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar ose tjetër, pa lejen paraprake të D4D.

Punim i përgatitur nga:

Allen Meta

—

Zhvillimi dhe publikimi i këtij dokumenti është përkrahur nga programi i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) 'EJA Kosovë', bashkëfinancuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Suedia, dhe Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e Institutit D4D dhe jo domosdoshmërisht paraqet qëndrimet e KCSF-së, SDC-së, Suedisë apo Luksemburgut.

Tabela e përmbajtjes

Hyrje	4
Metodologjia	5
Rezultatet e analizës së matjes së opinionit publik	6
<i>Kënaqshmëria e qytetarëve me shërbimet e pranuar nga zyrtarët komunal</i>	<i>6</i>
<i>Përfshirja e qytetarëve në vendimmarrjen komunale</i>	<i>9</i>
<i>Informimi i qytetarëve për punën e komunës</i>	<i>11</i>
<i>Pjesëmarrja e qytetarëve në dëgjime publike</i>	<i>13</i>
<i>Përditësimi i informatave të komunave në rrjetet sociale</i>	<i>16</i>
Përfundimet dhe rekomandimet	17

HYRJE

Pjesëmarrja e qytetarëve në hartimin e politikave dhe marrjen e vendimeve është thelbësore në demokracitë liberale. Rritja e transparencës dhe llogaridhënies së autoriteteve publike, përveç që ndikojnë në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike, janë të rëndësishme edhe për arritjen e standardeve evropiane të qeverisjes të mirë. Në mungesë të transparencës dhe llogaridhënies, përfshirja dhe interesimi i qytetarëve në marrjen e vendimeve zbehet dukshëm.

Institut Demokraci për Zhvillim (D4D), në fund të vitit 2022 ka realizuar anketë me 1,065 respondentë në lidhje me matjen e kënaqshmërisë së qytetarëve ndaj shërbimeve komunale, përfshirjes në vendimmarrje dhe informimit të tyre. Rezultatet e hulumtimit dhe vlerësimit në bazë të vlerësimit të respondentëve, tregojnë për nevojën që autoritetet komunale të përmirësojnë politikën në disa nga fushat e trajtuara brenda këtij raporti. Ekziston një hendek i madh ndërmjet autoriteteve komunale me qytetarët në aspektin e marrjes së informatave, pjesëmarrjes në vendimmarrje dhe mos informim për organizim të dëgjimeve publike. Të gjeturat e hulumtimit të opinionit publik tregojnë për nivel të ulët të kënaqshmërisë së qytetarëve me shërbimet e pranuar nga zyrtarët komunal, si dhe në kontakte të pakta me komunën e tyre. Po ashtu, niveli i përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje në nivel komunal nuk është i kënaqshëm, pasi rreth 2/3 e të anketuarave kanë deklaruar se nuk janë të përfshirë në asnjë formë.

Përderisa përfaqësimi i qytetarëve në vendimmarrje përcillet me hezitim dhe mosbesim, ky raport ka për qëllim të vlerësojë trendet dhe ofrojë rekomandimet për të përmirësuar politikën publike përmes përfshirjes më të madhe të qytetarëve.

METODOLOGJIA

Matja e opinionit publik mbi përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje në komunë është realizuar përmes anketimit të 1,065 respondentëve gjatë muajit dhjetor 2022, përmes mostrës përfaqësuese në nivel vendi. Respondentëve u janë parashtruar gjithsej pesë pyetje, duke ndjekur metodologjinë e mostrës së rastësishme. Pas mbledhjes së të dhënave është bërë analiza duke përdorur metodën deskriptive dhe analitike. Përmes metodës deskriptive tentojmë të krijojë një pasqyrë të qartë të shpërndarjes së mostrës, ndërsa në anën tjetër bëjmë analizimin e tyre që lexuesit t'a kenë më të qartë se çfarë realisht tregojnë këto rezultate.

Nga të dhënat e anketimit janë analizuar edhe kategoritë e tjera në bazë të gjinisë, moshës, vendbanimit, statusit të punësimit, edukimit dhe etnisë. Kjo ka mundësuar të shohim ndarjet dhe dallimet në secilën prej këtyre kategorive dhe të shohim sesi ndryshojnë rezultatet. Gjithashtu, gjetjet e kësaj ankete janë krahasuar nga hulumtimi i vitit 2019 dhe 2020 me pyetje, metodologji dhe mostër të njëjtë.

REZULTATET E ANALIZËS SË MATJES SË OPINIONIT PUBLIK


Për të vlerësuar kënaqshmërinë e qytetarëve me nivelin e transparencës dhe pjesëmarrjes në vendimmarrje në nivel lokal, është bërë matja e opinionit publik në nivel vendi përmes mostrës përfaqësuese. Anketa ka përmbajtur gjithsej pesë pyetje, përgjigjet e të cilat janë paraqitur dhe analizuar në vijim të këtij raporti. Në fund të analizës së secilës pyetje, të dhënat janë krahasuar me analizën e mëhershme të D4D-së, “[Raport mbi performancën e komunave në fushën e komunikimit me qytetarë/e](#)”, që është realizuar gjatë vitit 2019-2022.

Kënaqshmëria e qytetarëve me shërbimet e pranuar nga zyrtarët komunal

Në pyetjen e parashtruar për të matur kënaqshmërinë e qytetarëve me shërbimet që kanë pranuar nga zyrtarët komunal, krahas vlerësimit për nivelin e kënaqshmërisë me shërbimet është arritur të kuptohet edhe frekuenca e kontakteve që qytetarët kanë me komunën.

Të kënaqur apo shumë të kënaqur me shërbimet që kanë pranuar nga zyrtarët komunal janë shprehur 44.2% e të anketuarve. Ndërsa të pakënaqur dhe shumë të pakënaqur me janë deklaruar 17.3% e të anketuarve në nivel vendi. Nga analizimi gjinor i rezultateve vërejmë që nuk ka dallime të mëdha në përgjigje sa i përket kënaqshmërisë me shërbimet që kanë pranuar nga zyrtarë t komunal. Në pjesë e atyre që janë përgjigjur si shumë të kënaqur apo të kënaqur, 45.9% janë burra ndërsa 42.8% janë gra. Nga analiza gjinore e të dhënave për responentët që nuk janë të kënaqur apo shumë të pakënaqur me shërbimet që kanë pranuar nga zyrtarët komunal, 18.4% janë burra kurse 16% janë gra. Nga orientimi i analizës në nivel të vendbanimit shohim se në grupin e atyre që janë të kënaqur me shërbimet komunale, 44.1% e tyre janë me vendbanim urban, ndërsa 44.2% në atë rural. Në grupin e të pakënaqurve me shërbimet komunale, 18% janë në vendbanime urbane ndërsa 16.7% në ato rurale.

Grafi 1. Kënaqshmëria e qytetarëve me shërbimet e pranuar nga zyrtarët komunal, nëse kanë pasur kontakt në gjashtë muajt e fundit



Qytetarë të cilët nuk kanë kontaktuar me komunë në gjashtë muajt e fundit janë 37.6% e të anketuarve. Prej tyre më së shumti i takojnë kategorisë së pensionistëve, amviseve, të punësuar kohë pas kohe dhe të punësuar në sektorin publik. Nga analiza e aspektit gjinor, shohim se 34.7% janë burra, ndërsa 40.7% gra.

Analiza krahasuese


Në vlerësimin e vitit 2019 lidhur me kënaqshmërinë e qytetarëve me shërbimet e zyrtarëve komunal, del se 41.1% e qytetarëve të anketuar kanë qenë të kënaqur apo shumë të kënaqur, ndërsa në vitin 2020 kanë qenë 20.7% e qytetarëve. Nga ky krahasim, del se ka rritje të lehtë prej 3.1% në krahasim me vitin 2019, dhe rritje të ndjeshme prej 23.5% në krahasim me vitin 2020.

Përfshirja e qytetarëve në vendimmarrjen komunale

Pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje lokale është e garantuar me Ligji për Vetëqeverisje Lokale, ku çdo komunë është e obliguar të mbajë së paku dy herë në vit takime publike me qytetarë. Përkundër kësaj, pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrjen konsiderohet e mangët dhe kjo besohet të ketë ardhur për dy arsye. E para, bartësit e institucioneve nuk kanë zhvilluar praktika të duhura të inkurajimit të qytetarëve në proceset vendimmarrëse, dhe arsyeja e dytë, është mungesa e interesimit të qytetarëve për të marrë pjesë në këto procese konsultuese.

Nga hulumtimi ynë, në pyetjen e parashtruar rreth përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje në komunë, rezultatet na tregojnë se qytetarët kanë deklaruar se përfshirja e tyre në nivel lokal është mjaftë e ulët. Vetëm 35.8% e të anketuarve mendojnë se qytetarët janë të përfshirë apo shumë të përfshirë në vendimmarrje. Kurse, 50.6% e të anketuarve mendojnë se qytetarët janë të pa përfshirë apo shumë të pa përfshirë në vendimmarrjen komunale. Gjithashtu, nga përgjigjet e marra përmes anketës së realizuar shohim se 13.7% e qytetarëve nuk kanë qëndrim rreth pyetjes në fjalë ose refuzojnë të përgjigjen. E gjetur interesante e hulumtimit është rezultati në kategorinë e përkatësisë etnike ku 65.1% e të anketuarve nga komuniteti serb deklaruan që janë të pa përfshirë në proceset e vendimmarrjes në komunën e tyre, përkundër të anketuarve nga komuniteti shqiptar ku 37.7% e tyre mendojnë se qytetarët janë të pa përfshirë në vendimmarrje. Nga analiza gjinore, 40% e burrave të anketuar mendojnë se qytetarët janë të përfshirë apo shumë të përfshirë në vendimmarrjen komunale, dhe vetëm 31.7% e grave ndajnë këtë mendim. Shifra është më e lartë në

Grafi 2. Përfshirja e qytetarëve në vendimmarrjen komunale



mesin e grave të cilat mendojnë që nuk janë të përfshira apo shumë të pa përfshira në vendimmarrjen komunale në 52.1%, ndërsa në mesin e burrave këtë mendim e kanë 49%.

Po ashtu, te pjesa e edukimit dhe nivelit të shkollimit të përfunduar apo në fazë përfundimit, vërejmë që studentët e anketuar mendojnë se qytetarët janë të përfshirë ose shumë të përfshirë me 51.2% në total, e që ka dallim me përqindjen totale të po të njëjtave përgjigje me 15.4%.

Analiza krahasuese


Në analizën e vitit 2019-2020 nuk është parashtruar pyetja e përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje, që na ka pamundësuar zhvillimin e analizës krahasuese për të këtë pjesë.

Informimi i qytetarëve për punën e komunës

Transparenca dhe informimi proaktiv i qytetarëve për punën e autoriteteve të qeverisjes lokale është prej parimeve kryesore të qeverisjes së mirë. Në këtë drejtim, informimi duhet të ofrohet përmes përdorimit të kanaleve të ndryshme të komunikimit për të arritur audience të ndryshme, dhe assesi nuk duhet mjaftuar vetëm me komunikata për shtyp apo publikim në ueb faqet zyrtare të komunave.

Të dhënat nga analizimi i pyetjes së radhës na mundësojnë të kuptojmë se sa janë të informuar qytetarët për punën e komunës së tyre. Në rezultatet e mbledhura nga anketa me qytetarë, shohim se 42.3% e tyre konsiderojnë se janë të informuar mirë apo janë të informuar aq sa duhet. Të painformuar apo aspak të informuar kanë konsideruar që janë

Grafi 3. Informimin për aktivitetet e komunës



53.7% e të anketuara. Ndërsa 4% e qytetarëve të anketuar janë përgjigjur se nuk kanë qëndrim ose refuzojnë të përgjigjen.

Duke ju referuar rezultatit në përqindje relativisht të ulët mbi përgjigjen se qytetarët janë të informuar mirë mbi punën e komunës, zbërthejmë analizën në nivel të edukimit për të kuptuar nëse kjo ka rol në qasjen dhe marrjen e informatave. Këtu vërejmë se shpërndarja në përqindje më të lartë i takon kategorive si në vijim: me 9.6% shkollë fillore, 12.6% në fillim të studimeve dhe 15.6% magjistraturë ose doktoraturë, kurse pjesa tjetër (34.7%) me nivelet tjera të edukimit. Nga analiza e aspektit gjinor, burrat (46.1%) kanë deklaruar se janë më të informuar në raport me gratë (38.5%).

Analiza krahasuese


Nga analiza krahasuese me vitet 2019 dhe 2020, shohim se ka ndryshime pozitive. Qytetarë të cilët kanë deklaruar se janë të painformuar apo aspak të informuar për punën e komunës së tyre kur janë grupuar këto dy opsione, shohim se edhe në vitin 2019 dhe 2020 kanë qenë në nivel të njëjtë prej 60.7%. Nga krahasimi me të dhënat e tashme që arrijnë në nivel të 53.7% të painformuar apo aspak të informuar, del se ka një përmirësim të lehtë prej 7% të atyre që tash mendojnë se janë më të informuar.

Pjesëmarrja e qytetarëve në dëgjime publike

Një prej pyetjeve të cilat definon më së shumti përfshirjen e qytetarëve dhe parimet e qeverisjes së mirë është pjesëmarrja e qytetarëve në dëgjime publike të organizuara nga komuna e tyre. Mungesa e informimit jo vetëm për rëndësinë e dëgjimeve publike, por edhe për mbajtjen e tyre paraqet një rëndësor ndër problemet kryesore. Rezultatet në vazhdim tregojnë që komunat duhet të punojnë në dy drejtime sa i përket dëgjimeve publike, fillimisht duke arritur të përçojnë rëndësinë e pjesëmarrjes së qytetarëve në dëgjime publike, dhe pastaj duke krijuar mekanizma që informojnë qytetarët për mbajtjen e këtyre dëgjimeve.

Si në pyetjet e mëhershme, ashtu edhe në këtë pyetje, ne kemi vërejtur se përfshirja qytetare është shumë e ulët, me fokus të veçantë në dëgjime publike. Nga përgjigjet e marra del se 68.4% e qytetarëve nuk kanë marrë pjesë asnjëherë në dëgjime publike, pasi që nuk kanë qenë në dijeni për mbajtjen e tyre. Kurse, 27.1% e të anketuarve janë shprehur se përkundër që kanë qenë të informuar, asnjëherë nuk kanë marrë pjesë në dëgjime publike. Nga totali del se 95.5% e qytetarëve të anketuar nuk kanë marrë pjesë asnjëherë në dëgjime publike, 2.3% kanë marrë pjesë një herë, 1.9% 2 deri në 3 herë, ndërsa 0.3% kanë deklaruar se kanë marrë pjesë 4 herë apo më shumë. Në aspektin e analizës gjinore, 94.5% e burrave të anketuar nuk kanë marrë pjesë asnjëherë në dëgjime publike, ndërsa 96.3% e grave.

Grafi 4. Vlerësimi mbi pjesëmarrjen e qytetarëve në dëgjimet publike në gjashtë mujorin e fundit



Nga rezultatet e marra rezulton se 4.5% e qytetarëve të anketuar kanë marrë pjesë në total në 6 mujorin e fundit në dëgjime publike të organizuara nga komuna e tyre. Prej tyre 2.3% janë përgjigjur se kanë marrë pjesë 1 herë, 1.9% janë përgjigjur se kanë marr pjesë 2-3 herë në dëgjime publike, ndërsa 0.3% e tyre thonë se kanë marr pjesë 4 herë në dëgjime publike të organizuara nga komuna e tyre.

Analiza krahasuese

Analiza krahasuese ka vazhduar për të pasur më të qartë se sa shpesh kanë marrë pjesë qytetarët në dëgjime publike në vitin 2020 dhe çfarë ndryshime ka pësuar në vitin 2022.

Rezultatet e kësaj pyetje tregojnë që në vitin 2020, 6.2% e qytetarëve të anketuar kanë marrë pjesë vetëm një herë gjatë 6 muajve të fundit në dëgjime publike. Ndërsa, në vitin 2022 është vërejtur një ulje e pjesëmarrjes, ku vetëm 2.3% kanë

deklaruar se kanë marrë pjesë në këtë aktivitet. Përqindja e qytetarëve që kanë marrë pjesë në dëgjime 2 deri 3 herë gjatë muajve të fundit në vitin 2020, ka rezultuar të jetë 3.5%, vlerë e cila është më e lartë në krahasim me vitin 2022 ku ishte 1.9%.


Edhe pse rezultatet e kësaj analize tregojnë që vetëm 1.4% kanë marrë pjesë 4 apo më shumë herë në dëgjime publike në vitin 2020, kjo shifër mbetet më e lartë krahasuar me vitin 2022 (0.3%).

Përditësimi i informatave të komunave në rrjetet sociale

Duke qenë se përdorim i rrjeteve sociale në Kosovë është i lartë, në veçanti në platformën Facebook me rreth 870 mijë në vitin 2022, komunat patjetër duhet të kthejnë komunikimin me qytetarët edhe në rrjete sociale si mjet për informimin e tyre.

Nga anketa e zhvilluar, rezultatet që kemi marrë mbi këtë pyetje tregojnë se 54.5% e qytetarëve mendojnë se komunat janë shumë aktive ose aktive në rrjete sociale në përditësimin e informatave për qytetarët. Qytetarët e anketuar që mendojnë se komunat nuk janë aktive apo aspak aktive në rrjete sociale arrijnë në vlerën prej 28.9%, kurse që nuk kanë shprehur mendim apo kanë refuzuar të përgjigjen në këtë pyetje janë 16.3% e tyre. Është interesante të shihet se në aspektin gjinor nuk ka dallime sa i përket vlerësimit përket vlerësimit pozitiv për aktivitetin e komunave me 54.7% si për burrat ashtu edhe për gratë, kurse në aspektin e vendbanimit shohim një dallim të lehtë për qytetarët në vendbanime rurale që janë më të kënaqur për 1.2% në raport me ata në zona urbane.

Grafi 5. Aktiviteti i komunave në rrjetet sociale për të përditësuar informatat për qytetarët



Analiza krahasuese

Në analizën e vitit 2019-2020 nuk është parashtruar pyetja e përdorimit të rrjeteve sociale nga komunar, që na ka pamundësuar zhvillimin e analizës krahasuese për të këtë pjesë.

PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET

- 1 Analiza e të dhënave vë në pah dallime në përgjigje në vitet e ndryshme në disa prej pyetjeve të njëjta, të cilat i kemi realizuar në vitet paraprake.** Është konstatuar rritje e kënaqshmërisë në marrjen e shërbimeve nga zyrtarët komunal, për dallim nga vitet 2019 dhe 2020, edhe pse ende qëndron e ulët me 44.2%. Për të rritur kënaqshmërinë e qytetarëve me shërbimet e zyrtarëve komunal, duhet të bëhet rritja e ofrimit të shërbimet digjitale, që do të shkurtonte kohën e pritjes dhe marrjes së dokumenteve për qytetarët. Sportelet e komunave duhet të jenë më të qasshme dhe dizajnë miqësore për qytetarët. Zyrtarët komunal që ofrojnë shërbimet duhet të trajnohen për të ofruar shërbime. Në komunat ku ka mungesë të zyrtarëve, duhet të konsiderohet shtimi i kapaciteteve ose zhvendosja e stafit të tepërt.
- 2 Qytetarët shprehen se nuk janë të përfshirë në vendimmarrje në komunën e tyre.** Vetëm 35.8% e qytetarëve të anketuar mendojnë se janë të përfshirë apo shumë të përfshirë në vendimmarrje në komunën e tyre. Për të rritur përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje, komunat duhet të bëjnë organizime të takimeve individuale me qytetarët dhe grupe më të ngushta të interesit, me fokus në diskutimet për planifikim të investimeve kapitale. Komunat duhet të konsiderojnë themelimin e qendrave të thirrjeve përmes të cilave do të grumbulloheshin kërkesat e qytetarëve, por edhe organizmit të takimeve online për të diskutuar me qytetarët e interesuar.
- 3 Informimi i qytetarëve për aktivitetet e komunës është konsideruar si i mirë apo shumë i mirë nga 42.3% e të anketuarve.** Ndërsa 53.7% e qytetarëve të anketuar mendojnë

se nuk janë të informuar mirë ose aspak të informuar mbi punët e komunës së tyre. Andaj, komunat duhet të gjejnë mënyra adekuate të informimit të qytetarëve mbi punët e komunës, duke përdorur rrjetet sociale por edhe komunikimin direkt me qytetarë, dhe përfshirjen e tyre më të madhe që të ndikojnë në rritje të informimit. Komunat duhet të publikojnë të dhëna në formate të përpunueshme, si dhe të përdorim ueb faqet e tyre në mënyrë proaktive.

- 4 **Në bazë të anketës së realizuar vërejmë dy ekstremet sa i përket dëgjimeve publike.** Në grupin e parë janë personat të cilët nuk kanë marrë pjesë në dëgjime publike me 68.4% të tyre, ndërsa në grupin e dytë janë personat të cilët edhe pse kanë qenë të informuar nuk kanë marrë pjesë. Më tutje, në diskutimet me këshilltarët komunal kemi vërejtur që qytetarët kanë refuzuar të marrin pjesë me arsyen e mos marrjes parasysh të kërkesave të qytetarëve, por edhe mënyrës së dobët të informimit mbi mbajtjen e dëgjimeve publike. Për të adresuar këtë problem, komunat duhet të zhvillojnë fushata informuese për qytetarët që theksojnë rëndësinë e përfshirjes së qytetarëve në dëgjime publike, dhe të marrin rekomandimet e qytetarëve kur janë pjesë e këtyre dëgjimeve publike, si një prej modaliteteve të përfshirjes së tyre më të madhe.
- 5 **Nga hulumtimi në rrjete sociale kemi vërejtur që shumë prej komunave nuk i mirëmbajnë rrjetet e tyre sociale, përkundër që disa prej komunave më të mëdha janë mjaftë aktive.** Përdorimi i rrjeteve sociale në Kosovë është shumë i lartë nga qytetarët dhe si i tillë mund të shërbejë si një prej mjeteve komunikuese qytetarë-komunë. Komunat duhet të rrisin përdorimin e rrjeteve sociale dhe zgjerimin e audiencës, duke përdorur edhe grafika dhe video të shkurta të cilat do të ishin më atraktive për qytetarët.

Instituti Demokracia për Zhvillim (D4D) është themeluar në prill të vitit 2010 nga një grup i analistëve që po brengoseshin gjithnjë e më shumë që procesi i shtetndërtimit e kishte lënë anash demokracinë. Vizioni i D4D-së është të promovojë një qytetari aktive dhe të arsimuar, e cila merr pjesë plotësisht në hapësirën publike dhe e përdor arenën publike për përfaqësim dhe vendim-marrje për të diskutuar dhe ndërtuar konsensus për shpërndarjen e resurseve që janë efikase, të shpejta, afatgjate dhe që sjellin zhvillim të barabartë. D4D ndikon në politikat specifike, promovon një qasje ndërsektoriale për zgjidhjen e problemeve dhe trajton rutinën institucionale të vendimmarrjes duke rekomanduar përmirësime në rritje dhe operon me efektivitet maksimal në mënyrë që të promovojë plotësisht stabilizimin e Kosovës dhe zhvillimin demokratik.

Për më shumë informata rreth aktiviteteve të D4D-së, ju lutemi vizitoni faqen tonë elektronike: www.d4d-ks.org

Mbështetur nga:

